

<i>Emërtimi i lëndës</i>		<b>KËRKIMI SHKENCOR</b>		<b>KODI (BIO 470)</b>
<i>Viti</i>		II		
<i>Semestri</i>		I		
<i>Vendin që zë lënda në formimin tërësor të studentit</i>		<b>Lëndë të detyrueshme / Kërkim shkencor</b>		
<i>Përshkrimi</i>		<p>Lënda e Kërkimit shkencor synon tu japë studentëve të masterit njohuri bazë mbi nevojat e njeriut për njohje, njohja si fenomen shoqëror, përmbajtja dhe mekanizmi i njohjes, formulimi i dijes, njohja si unitet i elementit shqisor dhe racional, niveli empirik dhe teorik i njohjes, kuptimi për të vërtetën, njohja shkencore dhe kategoritë kryesore të saj. Gjithashtu, në leksione do të trajtohen temat si: hipoteza, ngritja e hipotezës, vëzhgimi dhe protokollimi i të dhënave, përdorimi i metodologjisë në kërkim, përcaktimi i objektit dhe planit të studimit, dallimi midis metodave dhe metodologjisë, metodat sasiore dhe ato cilësore, vëzhgimi empirik dhe <i>skica e kërkimit empirik</i>, përcaktimi i mënyrës së matjes nëpërmjet koncepteve themelore të njohjes shkencore, « Njësitë e analizës » apo « rastet » si objekte, « Kampioni » i « popullatës teorike », « Vetitë » apo « variablat ».</p> <p>Studentët e masterit do të marrin njohuri për përgatitjen e pyetsorit, natyrën e problemeve praktike kërkimore, hipotezat dhe mënyrat e vërtetimit të tyre, gabimet e mundshme gjatë formulimit të hipotezave, rolin e teorisë dhe literaturës në shpjegimin e hipotezave dhe vërtetimin e tyre, kërkimet eksploruese, vëzhgimet shkakësore, njësitë e analizës, tipet e kampionimit dhe përzgjedhja e kampionit, përkufizime dhe matje, mbledhja e të dhënave, vëzhgimi dhe pjesëmarrja vëzhguese, përdorimi i të dhënave arkivore, besueshmëria e koleksioneve arkivore, kodimi i të dhënave për analizë statistikore, intervista dhe anketa, metoda analitike dhe sintetike, metoda abstrakte dhe konkrete, analiza konkrete e situatës konkrete dhe metodat statistikore.</p>		
<i>Ngarkesa në orë</i>		<i>Në auditore</i>		
		90 orë		
		<i>Jashtë auditorit</i>		
		85 orë		
<b>Kreditet</b>		<b>7 ETCS = 175 orë</b>		
<i>Format e mësimdhënies</i>		<i>Kredite (ECTS)</i>	<i>Auditor (orë)</i>	<i>Studim (orë)</i>
	<b>Gjithësej</b>	<b>7</b>	<b>90</b>	<b>85</b>
<i>Temat që do trajtojë lënda në formimin teorik</i>		<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Njohja si fenomen shoqëror. Nevoja e njeriut për njohje. (1 orë)</li> <li>2. Ndërgjegjia dhe njohja. Njohja si fenomen shoqëror. Subjekti dhe objekti i njohjes . (1 orë)</li> <li>3. Përmbajtja dhe mekanizmi i njohjes. Njohja si bashkëveprim i subjektit dhe objektit të njohjes. (1 orë)</li> <li>4. Formulimi i dijes. Njohja si unitet i elementeve shqisore dhe racionale. Niveli empirik dhe teorik i njohjes. (1 orë)</li> <li>5. Kuptimi për të vërtetën. E vërteta si proces. A mund të provohet e vërteta? (1 orë)</li> <li>6. E vërteta dhe gabimi. Argumentimi i së vërtetës. (1 orë)</li> <li>7. Njohja shkencore dhe kategoritë kryesore të saj. Kuptimi për njohjen shkencore. (1 orë)</li> <li>8. Hipoteza. Ngritja e hipotezës. Problemi dhe situata problemore. (1 orë)</li> <li>9. Vëzhgimi dhe protokollimi i të dhënave . Ecuria e njohjes shkencore. (1 orë)</li> <li>10. Përdorimi i metodologjisë në kërkim. Përcaktimi i objektit dhe planit të studimit. (1 orë)</li> <li>11. Dallimi midis metodave dhe metodologjisë. Kuptimi për</li> </ol>		
45 orë leksione				

	<p>metodën e njohjes. Metodatat sasiore dhe ato cilësore. (1 orë)</p> <p>12. Vëzhgimi empirik dhe skica e kërkimit empirik. Paraqitja e problemit: fusha e përgjithshme e kërkimit, përse është i rëndësishëm dhe çfarë pikërisht do të studjohet. (1 orë)</p> <p>13. Zgjedhja e mënyrës së kampionimit të njësive të përcaktuara. (1 orë)</p> <p>14. Përcaktimi i mënyrës së matjes nëpërmjet zgjedhjes së metodës (eksperiment; pyetësor ankete, që përfshijnë 'testimin'; kërkime arkivore etj. (1 orë)</p> <p>15. Përcaktimi i procedurës së matjes dhe operacionalizimi i koncepteve. (1 orë)</p> <p>16. Koncepte themelore të njohjes shkencore. « Popullata teorike » si tërësi e objekteve ndaj të cilave zbatohet shpjegimi shkencor. Tipet e ndryshme të popullatës. (1 orë)</p> <p>17. « Njësitet e analizës » apo « rastet » si objekte (individë, grupe, kombe etj.) mbi të cilët mblidhen të dhëna me procedurë kërkimore empirike. Ushtrime praktike në përcaktimin e tipeve të ndryshme të « njësive të analizës ». « Kampioni » i « popullatës teorike » si tërësia e njësive që analizohen konkretisht gjatë vëzhgimit shkencor empirik. (1 orë)</p> <p>18. « Vetitë » apo « variablat » si karakteristika, attribute apo tipe sjelljesh në lidhje me të cilat dallohen njësitet në popullatat teorike. Variablat konceptuale dhe operacionalë. (1 orë)</p> <p>19. Variablat e pavarur ('shkaqet') ose 'shpjegues', variablat e varur ('pasojat') ose variablat 'kriter' dhe variablat ndërmjetës. Variablat e thjeshtë dhe të përbërë. Tipet e vetive: vetitë cilësore dhe sasiore. Vetitë dihotomike. Disavantazhet praktike të zgjedhjes së vetive dihotomike. (1 orë)</p> <p>20. Përgatitja e pyetësorit. Pyetjet me domethënie të gjerë. Nga pyetjet në problemet. Dy tipet e problemeve: problemet praktike dhe problemet kërkimore. Struktura e përbashkët e problemeve. (1 orë)</p> <p>21. Natyra e problemeve praktike dhe ajo e problemeve kërkimore. Problemi kërkimor dhe pasojat praktike. (1 orë)</p> <p>22. Hipotezat dhe mënyrat e vërtetimit të tyre. Kuptimi për hipotezën. Pse lind dhe si formulohet ajo. Hipoteza si thënie që synon të shpjegojë variacionin në vetinë që ne shqyrtojmë si rezultat apo pasojë e variacionit në një veti tjetër. Dallimi midis hipotezës dhe një supozimi. (1 orë)</p> <p>23. Hipotezat e thjeshta dhe ato të përbëra. Format e hipotezave. Hipotezat me lidhje të shtrira në kohë dhe në hapësirë. (1 orë)</p> <p>24. Ndërtimi i hipotezave. Informacioni që jepet në hipotezë: popullata teorike, marrëdhënia midis vetive, njësitet. Shmangia e gjykimeve të vlerës dhe e referimit ndaj popullatave teorike të kufizuara. (1 orë)</p> <p>25. Llojet e hipotezave. Hipotezat konceptuale, operacionale dhe hipotezat zero. Testimi i hipotezave. Lidhja midis variablave (vetive) të varur dhe atyre të pavarur. Karakteri shkakësor i lidhjes. Mbajtja konstante e variablave të tjerë. (1 orë)</p> <p>26. Gabimet e mundëshme gjatë formulimit të hipotezave: referimi vetëm tek një veti; paraqitje e paqartë e lidhjes midis kategorive apo niveleve të variablit; mungesa e përgjithësimin në thënie dhe hipotezës dhe thënie në formën e gjykimeve të vlerës (preferenca, etj.). (1 orë)</p> <p>27. Roli i teorisë dhe literaturës në shpjegimin e hipotezave dhe vërtetimin e tyre. Dy rrugët e arsyetimit për të shtjelluar shpjegime në formë hipotezash: Nxjerrja nga teoritë dhe nga përgjithësimi i hipotezave të mëparshme. (1 orë)</p> <p>28. Kërkimet eksploruese. Vëzhgimet shkakësore. Gjetja e burimeve në literaturën profesionale. Justifikimi i kërkimit (studimit). Ritestimi i hipotezave të mëparshme. (1 orë)</p> <p>29. Njësitet e analizës. Përcaktimi i llojit të njësive. Zëvendësimi i individëve me grupe. Simulimi dhe kushtet e pranimit të tij. (1</p>
--	---

	<p>orë)</p> <p>30. Përcaktimi i numrit të njërive në përputhje me saktësinë e nevojshme dhe numrin e shpërndarjen e kategorive për çdo veti. (1 orë)</p> <p>31. Kurba e varësisë së madhësisë së kampionit me vlerësimin e gabimit dhe sugjerime praktike mbi madhësinë e kampionit. (1 orë)</p> <p>32-33. Tipet e kampionimit dhe përzgjedhja e kampionit. Kampionet, llojet e tyre. (2 orë)</p> <p>34. Përkufizime dhe matje. Nevoja për matje dhe mënyra e realizimit të tyre. Përkufizimi i vetive, qartësia, qëndrueshmëria. (1 orë)</p> <p>35. Niveli i matjes dhe shënimi i vlerave. Kriteria për vlerësimin e matjeve. Besueshmëria dhe përcaktimi i besueshmërisë. Vlefshmëria dhe përcaktimi i vlefshmërisë. Tipet e vlefshmërisë: vlefshmëria e brendshme, e jashtme dhe e ndërtimeve (koncepteve). Vleftësimi i matjeve indirekte. (1 orë)</p> <p>36. Mbledhja e të dhënave. Tipet e mbledhjes së të dhënave. (1 orë)</p> <p>37. Vëzhgimi dhe pjesëmarrja vëzhguese. Analiza e përmbajtjes. Vëzhgimet indirekte. (1 orë)</p> <p>38. Përdorimi i të dhënave arkivore. Besueshmëria e koleksioneve arkivore. Vlefshmëria e të dhënave arkivore. Burimet e të dhënave arkivore. Kodimi i të dhënave për analizë statistikore. (1 orë)</p> <p>39. Intervista dhe anketa. Kuptimi për intervistën dhe mënyra e vlerësimit të saj. Ndërtimi i pyetjeve të vlefshëm. Pyetjet e përbëra. (1 orë)</p> <p>40- 41. Ndërtimi dhe vlefshmëria e pyetësorit. Realizimi i anketës. Problemi i mospërgjigjeve në anketë. Veprimi i intervistuesit në besueshmërinë. (2 orë)</p> <p>42. Metoda të tjera të kërkimit shkencor. Metoda analitike dhe sintetike. (1 orë)</p> <p>43. Metoda abstrakte dhe konkrete. (1 orë)</p> <p>44. Analiza konkrete e situatës konkrete. (1 orë)</p> <p>45. Metodatat statistikore. (1 orë)</p>
--	--